



BASHKIA KAMËZ

PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR 2025 – 2027

*Plani për përmirësimin
e shërbimit të Arsimit
Parashkollor në
Bashkinë Kamëz është
një dokument strategjik
që ka për qëllim të
përmirësojë cilësinë e
edukimit në të gjitha
kopshtet që
funksionojnë nën
juridiksionin e Bashkisë
Kamëz.*

DHJETOR 2024

Përmbajtja

1. Hyrje	3
1.1 Qëllimi	3
1.2 Shtrirja.....	4
1.3 Vizioni.....	4
1.4 Misioni	4
1.5 Objektivat.....	5
1.6 Përgjegjësit	5
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	6
2.1 Qëllimi i proceseve të menaxhimit	6
2.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve të menaxhimit	6
2.3 Regjistrimi i fëmijëve	6
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	6
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor	16
2.4.1 Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit.	16
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit.....	23
3.1 Qëllimi i proceseve kryesore.....	23
3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore.....	23
3.3 Përfshirja sociale	23
3.3.1 Koncepti i përfshirjes sociale	23
3.3.2 Identifikimi i nevojave për përfshirje	23
3.4 Mbrojtja e fëmijëve	24
3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës.....	24
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	33
4.1 Qëllimi i proceseve mbështetëse	33
4.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve mbështetëse	33
4.3 Burimet Njerëzore.....	33
4.3.1 Trajnimi i stafit	33
4.4 Menaxhimi i godinave	38
4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve	38
5. Materialet	46
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale	46
6. Buxheti.....	49
7. Lista e plotë e aktiviteteve/projekteve	50

1.Hyrje

Në Shqipëri në kuadrin e ndryshimeve politike, në vitin 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë kuadër për shkak të decentralizimit, bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t’ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar m Neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për “*Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*” Në këtë kuadër, Bashkia ka hartuar një plan për Përmirësimin e Shërbimit të Arsimit Parashkollor.

Analizimi i situatës dhe përcaktimi i piketave për të ardhmen është ndërmarrë me kontributin e veçantë të Drejtorisë së Arsimit të Bashkisë Kamëz, të grupit të punës përgjatë takimeve periodike. Kontribut të vyer kanë ofruar mësues dhe drejtues të arsimit parashkollor si me sugjerime gjatë takimeve të hapura konsultuese, ashtu dhe me kontribut shkresor për veprimtaritë e tyre që kontribuojnë në arritjen e objektivave të Planit, drejt vizionit për një përmirësim cilësor dhe sasior të shërbimit. Drejtimi metodologjik është mbështetur nga programi “Bashki të Forta”, në kuadër të asistencës së Qeverisë Zvicerane përmes SDCsë, zbatuar nga Smart Processes. Ekspertët e Smart Processes, ka ndërmarrë udhëheqjen metodologjike dhe lehtësimin e takimeve periodike për rrahjen e ideve dhe identifikimin e sfidave, objektivave dhe masave.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parashkollor. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Kamëz. Plan i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

1.1 Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Kamëz dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Planifikim dhe parashikim i regjistrimit të fëmijëve në të gjitha kopshtet e bashkisë Kamëz nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat vendore për sigurimin e informacionit të nevojshëm për numrin e fëmijëve dhe jo vetëm.
- Organizimi dhe menaxhimi i të dhënave të kopshteve në strukturën e arsimit për bashkinë Kamëz, sipas të cilës sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet.
- Fuqizim dhe monitorim i vazhdueshëm i organizmave tëkopshteve.

- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës.
- Identifikim i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe fëmijëve me AK dhe promovim i politikave të mbrojtjes së fëmijëve.
- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimërimin e shërbimit në kopshtet që kanë nevojë të menjëhershme për restaurim mirëmbajtje apo rindërtim.
- Shtimi i kopshteve dhe hapësirave të reja edukuese si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për marrjen e shërbimit.
- Sigurim i vazhdueshëm i materialeve didaktike në kopshtet ku mungojnë nëpërmjet unifikimit të një liste me materiale didaktike.

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore lidhur me Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjike të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektive të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm dhe më pas aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e vendosur.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

1.2 Shtrirja

Plani për përmirësimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor në Bashkinë Kamëz është një dokument strategjik që ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e edukimit në të gjitha kopshtet që funksionojnë nën juridiksionin e Bashkisë Kamëz. Ky plan do të zbatohet të gjitha institucionet parashkollore të kësaj bashkie përgjatë tre viteve të ardhshme, 2025 - 2027.

Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të këtij plani dhe për të garantuar që çdo aktivitet të realizohet në përputhje me objektivat e tij, do të kujdeset Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sportit e cila është përgjegjëse për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Kamëz. Kjo Drejtori, do të monitorojë dhe vlerësojë përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara, duke ofruar mbështetje dhe udhëzime për kopshtet përkatëse përgjatë tre vjeçarit të ardhshëm.

1.3 Vizioni

Të fuqizojmë sistemin e menaxhimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Kamëz përmes rritjes dhe kapacitimit të strukturave, burimeve njerëzore, infrastrukturës e materialeve, me synim përmirësimin drejt një standardi shumë të mirë të shërbimit, gjithpërfshirës për fëmijët në kopshtet tona.

1.4 Misioni

Të përmirësojmë kushtet në ambientet arsimore dhe cilësinë e shërbimeve, për një nivel cilësor edukimi dhe mbështetjeje për çdo fëmijë në moshë kopshti, me qëllim sigurimin e një zhvillimi dhe edukimi të plotë dhe të barabartë, për të gjithë fëmijët.

1.5 Objektivat

- Organizimi i të gjitha të dhënave për arsimin parashkollor në një regjistër të strukturuar për kopshtet.
- Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit dhe formalizimi i procedurës.
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve duke rritur ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve të kopshteve dhe vetë komunitetit.
- Themelimi atje ku mungon, dhe fuqizim i organizmave të kopshtit (Këshilli i Prindërve, Bordi).
- Identifikimii i fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe fëmijëve me AK.
- Rikonstruksion i kopshteve, dhe ndërtim i kopshteve të reja.
- Sigurim i materialeve didaktike për të gjitha kopshtet sipas grupmoshave.

1.6 Përgjegjësit

1. Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtuesit e kopshteve;
 - Mësuesit e kopshteve;
 - Komuniteti;
 - PMF-të;
 - Psikologët;
 - GTN;
 - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
 - Kryetari i Bashkisë;
 - Këshilli i Bashkisë.

2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

2.1 Qëllimi i proceseve të menaxhimit

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

2.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve të menaxhimit

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Planifikimi dhe parashikimi bazuar në të dhëna të sakta dhe të unifikuara mes institucioneve të ndryshme në lidhje me arsimin parashkollor.
2. Krijimi i një regjistri me të dhëna të unifikuara për kopshtet nga çdo drejtori.
3. Shpërndarje e drejtë e regjistrimeve nëpërmjet regjistrimit të fëmijëve sipas vendbanimit.
4. Rritje e bashkëpunimit Kopsht-Komunitet.
5. Fuqizimi i organizmave të kopshteve në çdo kopsht të Bashkisë Kamëz.

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

Duke u bazuar në numrin e regjistrimeve në kopshtet publike në territorin e Bashkisë Kamëz, vihet re që se në këto kopshte nuk ka mbipopullim. Duke qenë se Kamza është një bashki me përqendrim shumë të lartë të popullsisë, në shumicën e territorit, vihet re se edhe numri i kopshteve është i lartë për të gjitha njësitë duke bërë kështu që kopshtet të mos jenë të mbipopulluar por brenda kapaciteteve. Bashkia Kamëz, edhe për shkak të përqendrimit të lartë të popullsisë, ka vazhduar vit pas vitit duke rritur kapacitetin akomodues dhe cilësinë në kopshte në të gjitha njësitë e saj.

Tendenca e prindërve për të regjistruar fëmijët e tyre nga kopshtet private tek ato publike ka qenë e lartë në Bashkinë Kamëz, çka dëshmon edhe numrin e ulët të kopshteve private në territor. Në territorin e bashkisë ka 20 kopshte publike dhe vetëm 6 kopshte private të shpërndara në të katërta Njësitë Administrative.

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë është 3860, ndër të cilët 1946 ose 50% janë vajza. Për të bërë një parashikim dhe një planifikim të numrit të fëmijëve në të gjitha kopshtet e bashkisë Kamëz, do të duhet të ndërmerren hapa për mbledhjen e të dhënave të cilat konsistojnë në dërgimin e kërkesave ndaj institucioneve përgjegjëse për të marrë një informacion të qartë për numrin e fëmijëve dhe jo vetëm. Në këtë mënyrë i gjithë informacioni do të jetë i

strukturuar dhe do të shërbejë për të bërë një planifikim dhe parashikim të situatës së fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç, ndjekës të kopshtit.

Objektiva specifike:

Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit për të siguruar shpërndarje të barabartë të fëmijëve në kopshte, bazuar në kapacitetin pritës të kopshteve.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve
2	Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet
3	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti dhe regjistrimi i tyre sipas procedurave formale dhe vendbanimit

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma
001	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
002	Krijimi i një regjistri të dhënash, i cili përmban të dhëna analitike për kopshtin	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
003	Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
004	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.

Përshkrim i Aktiviteteve/Projekteve

Nr. 001	Projekti: Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit në bashkinë Kamëz grumbullon të dhëna për numrin e fëmijëve 3-6 vjeç për të bërë të mundur planifikimin dhe parashikimin e shërbimit në të gjitha kopshtet e territorit të saj. Informacioni i mbledhur, do të duhet të bëhet vit pas viti në mënyrë që vetë Drejtoria, të bëjë një planifikim dhe parashikim të qartë të numrit të fëmijëve në moshë kopshti.		
Përmbledhja e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Pa një listë të saktë dhe të detajuar, është e vështirë të përcaktohet numri i nevojshëm i fëmijëve në moshë kopshti dhe planifikimi në kohë i shërbimit dhe rritjes së aksesit për përfshirje. Për të përcaktuar normën e pritshme të regjistrimit të fëmijëve në kopshte, është e nevojshme të analizohet historiku i regjistrimeve dhe të identifikohen trendet e kaluara, duke e krahasuar me të dhënat aktuale për regjistrimet e fundit. Kjo do të ndihmojë në vlerësimin e tendencave aktuale dhe faktorëve ndikues, si rritja e popullsisë dhe zhvillimet sociale. Bazuar në këtë analizë, do të përcaktohet norma e pritshme për secilin vit, që do të shërbejë si bazë për planifikimin e regjistrimeve. Po ashtu, shkalla e pritshme e frekuentimit do të vlerësohet në përputhje me tendencat e kaluara dhe aktuale, për të përcaktuar numrin e fëmijëve që pritet të frekuentojnë kopshte.		
ii Synimi i projektit Një mënyrë për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë Kamëz është bashkëpunimi me Zyrën e Gjendjes Civile, Qendrat Shëndetësore, koordinimi me Drejtorinë e Shërbimit Social, marrja e informacionit nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Programi për Aftësi të Kufizuara dhe mbledhja e informacionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve. Bashkëpunimi me këto struktura do të sigurojë një informacion të qartë për numrin e fëmijëve, grupmoshën, gjininë, Njësine Administrative dhe do të ndihmonte në planifikim të shërbimit. 1. Kështu, mund të identifikohen fëmijët në moshë kopshti që nuk janë regjistruar. Në këtë mënyrë, drejtorët dhe mësueset e kopshteve mund të kryejnë takime me prindërit për të kuptuar arsyet e mos regjistrimit të fëmijëve të tyre në kopsht dhe informimin mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmijëve. Në këtë mënyrë, synohet të rritet numri i fëmijëve që regjistrohen dhe ndjekin kopshtin. 2. Ky proces do të çojë në lehtësim të regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit.		
iii Niveli i ndërhyrjes 1. Dërgimi i kërkesës për marrjen e informacionit drejt strukturave përgjegjëse si: - Gjendja Civile pranë bashkisë ose Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile - Qendrat Shëndetësore - Drejtoria e Shërbimit Social në bashkinë Kamëz - Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve - Zyra për Administrimin e Ndihmës ekonomike Informacioni do të përmbajë karakteristikat të dhëna të nevojshme (emri i fëmijëve, ditëlindja, vendbanimi, aftësia etj) në varësi të institucionit ku do të drejtohet kërkesa.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Parashikimi i fëmijëve në moshë kopshti për grpmoshën 3-6 vjeç. 2. Përcaktimi i normës së pritshme të regjistrimit duke konsideruar historikun e regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga vitet e kaluara dhe duke identifikuar trendet dhe ndryshimet në numrin e regjistrimeve. 3. Vlerësimi i shkallës së pritshme të frekuentimit në kopshte, bazuar në shkallën e frekuentimit të viteve të kaluara dhe tendencat aktuale për të përcaktuar numrin e fëmijëve që pritet të frekuentojnë kopshtet në secilin vit.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Zhvillimi dhe zbatimi i procedurës standarte për identifikimin e të gjithë fëmijëve të pritshëm për t'u regjistruar. 2. Sigurimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës. 3. Rritja e shkallës së përfshirjes dhe frekuentimit.		

4. Përgatitje e programit mësimor.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) - Gjendja Civile. - Administratorët e njësive administrative - Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale - Zyra për Administrimin e Ndhmës ekonomike.			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) - Qendra Shëndetësore - Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve.			
e) Shpenzimet e llogaritura ¹ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Parashikimi i fëmijëve në moshë kopshti për grupmoshën 3-6 vjeç.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Përcaktimi i normës së pritshme të regjistrimit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Vlerësimi i shkallës së pritshme të frekuencimit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

¹ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr. 002	Projekti: Krijimi i një regjistri të dhënash i cili përmban të dhëna analitike për kopshtin	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Në Bashkinë Kamëz mungesa e një regjistri të dhënash për kopshtet, i cili është thelbësor për analizimin e situatës aktuale dhe parashikimin e gjendjes së tyre në të ardhmen, mund të sjellë problematika dhe vështirësi në procesin e funksionimit të kopshteve. Të dhënat që do të përmbajë ky regjistër, janë të dhëna shumë thelbësore për numrin e fëmijëve, frekuentimin e fëmijëve, situatën e regjistrimeve, të dhëna për proceset mbështetëse, kryesore dhe menaxhuese të cilat përfshijnë të dhëna për numrin e grupeve, për gjininë, burimet njerëzore, funksionalitetet, godinat, nevojat për rikonstruksion, informacion nga shërbimet sociale etj.		
ii Synimi i projektit Një mënyrë për të pasur një unifikim të të dhënave në kohë reale është krijimi i një regjistri Excel i cili përmban të dhëna analitike për kopshtin. Nëpërmjet këtij projekti synohet rakordimi i të dhënave dhe koordinimi mes Bashkisë, Njësi Administrative, ZVAP dhe kopshteve dhe lehtësimi i procesit të vlerësimit të nevojave që ka çdo kopsht. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që situata e arsimit parashkollor të jetë e qartë.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevojës për ndërhyrje		
Në Bashkinë Kamëz, nevojitet një sistem i mirë i regjistrimit të të dhënave në format regjistri Excel, i cili mungon. Kjo ndikon në aftësinë për të monitoruar progresin dhe për të planifikuar ndihmë dhe mbështetje të nevojshme për çdo fëmijë. Të dhënat, janë shumë të nevojshme për analizimin e situatës në kopshte dhe parashikimin e ardhshëm të gjendjes së tyre, që kanë të bëjnë jo vetëm me regjistrimin dhe trendin e regjistrimeve në të ardhmen por edhe me elementë të tjerë që lidhen me aspekte të ndryshme të funksionimit të kopshteve.		
iii Hapat e ndërhyrjes 1. Plotësimi i të dhënave nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. 2. Hedhja dhe unifikimi i të dhënave të mbledhura në regjistrin Excel të krijuar. 3. Dërgimi i të dhënave të ZVAP dhe Njësi Administrative.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Krijimi i një regjistri për hedhjen e të dhënave nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit në bashki 2. Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave, mënyrën e plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave. Stafi i kopshteve, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Ndihmës ekonomike dhe çështjeve sociale njihet me rregulloren. 3. Hedhja e të dhënave për secilin komponent të kopshteve të NjA Kamëz		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Regjistri me të dhëna individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale 2. Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve 3. Zgjidhja e problemeve në kohë reale		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale • Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve • Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit • Drejtoria e Burimeve Njerëzore Njësite administrative • Drejtoria e Shërbimeve Publike • Kopshtet		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • ZVAP
e) Shpenzimet e llogaritura² (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)		

² Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Krijimi i një regjistri për hedhjen e të dhënave.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Hedhja e të dhënave për secilin komponent për kopshtet	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

Nr. 003	Projekti: Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Regjistrimi i fëmijëve në kopshte bëhet kryesisht sipas vendbanimit të tyre, por në raste të veçanta lejohet edhe regjistrimi jashtë zonës për të përmbushur nevojat e familjeve, veçanërisht kur kopshti ka vende bosh. Kjo situatë ndodh shpesh për shkak të punësimit të prindërve në afërsi të kopshtit, duke u mundësuar atyre që të kenë akses më të lehtë në shërbimet edukative për fëmijët e tyre. Prioritet u jepet gjithashtu fëmijëve në nevojë, ku bashkia bashkëpunon ngushtësisht me shërbimet sociale për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve pranë vendit të punës së prindërve ose pranë shtëpive të gjyshërve, për të garantuar një mbështetje më të madhe për këto familje. Në lidhje me marrëdhëniet mes prindërve dhe kopshteve, është hartuar një kontratë tip mes prindërve dhe kopshtit, e cila zbatohet vetëm për kopshtet që ofrojnë ushqim. Kjo kontratë ndihmon në përcaktimin e përgjegjësisë dhe pritshmërive të dy palëve, ndërsa për kopshtet e tjera nuk ka një strukturë të tillë, çka mund të shkaktojë paqartësi në marrëdhëniet mes prindërve dhe stafit të kopshtit.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Shpërndarja e paekuilibruar e fëmijëve në kopshte çon në mbipopullim në disa institucione dhe nënpopullim në të tjerë. Ky mbipopullim shkakton vështirësi në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve, duke ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimeve edukative. Nga ana tjetër, nënpopullimi bën që hapësirat, të cilat janë investuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, të mos shfrytëzohen maksimalisht.		
ii Synimi i projektit		
Ky projekt ka për qëllim të sigurojë një shpërndarje të barabartë të fëmijëve në kopshte, duke garantuar që cilësia e shërbimeve edukative të jetë e njëjtë për të gjitha institucionet. Regjistrimi i fëmijëve do të kryhet kryesisht sipas zonës së banimit, në vend të preferencave individuale të prindërve. Për këtë, projekti do të fokusohet në hartimin dhe zbatimin e një rregulloreje që do të udhëheqë të gjitha kopshteve në procesin e regjistrimit, duke garantuar kështu një qasje të drejtë dhe transparente për të gjithë fëmijët dhe familjet.		
iii Niveli i ndërhyrje		
Në këtë rregullore do të përcaktohet qartë që: • <i>Prindërit, përveç dokumenteve të tjera, duhet të dorëzojnë edhe Certifikatën e Vendbanimit. Afati për dorëzimin e dokumenteve është nga 1 deri më 10 qershor.</i> • <i>Kopshti dorëzon dokumentet e marra nga prindërit në DPLAKBNJ brenda 2 ditëve pas përfundimit të afatit të regjistrimit.</i> • <i>DPLAKBNJ shqyrton dokumentet dhe, bazuar kriteret ligjore (*sipas zonës së banimit) dhe kriteret të tjera të miratuara në PSV, vendos mbi pranimin dhe shpërndarjen e fëmijëve në kopshte. Afati për kryerjen e regjistrimeve dhe marrjen e vendimeve është deri në fund të qershorit. Gjatë kësaj kohe punohet për identifikimin dhe regjistrimin në vijimi të fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në kopshte.</i> 1. Marrëveshja Prindër-Kopsht: Hartimi dhe zbatimi i kontratës mes prindërve dhe kopshtit, kontratë në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. 2. Takimet me prindërit dhe identifikimi e regjistrimi i fëmijëve në nevojë: Pas përfundimit të regjistrimeve, drejtorët apo mësuesit e kopshtit takojnë prindërit që nuk kanë regjistruar fëmijët e tyre për të kuptuar arsyet dhe për t'i informuar mbi rëndësinë e arsimit parashkollor. Kjo punë kryhet gjithashtu edhe punonjësve të terrenit për të identifikuar fëmijët në situatë rruge.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit; 2. Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve; 3. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht; 4. Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)		
1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit; 2. Shpërndarje e njëjtë e regjistrimit të fëmijëve; 3. Rritje e numrit të regjistrimeve;		

4. Ulje e numrit të grupeve të përziera dhe/ose numrit të fëmijëve në këto grupe.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)				
- Kryetar i Bashkisë - Drejtuës/Mësues/Grupet e Terrenit - Mësuese - Drejtorja e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale - Njësitë administrative - Kryetaret e Fshatrave - Ndërlidhësit komunitar		- Prindërit/Persona me përgjegjësi prindërore - Organizata të shoqërisë civile				
e) Shpenzimet e llogaritura ³ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emërtimi i aktiviteteve	Buxheti faktik	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Hartimi i një Procedure Standarte të Veprimit (PSV) “Për regjistrimin e fëmijëve në kopshte”	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Hartimi dhe zbatimi i kontratës mes prindërve dhe kopshtit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Takime me Prindërit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
4	Identifikimi dhe regjistrimi i Fëmijëve në nevojë	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027		g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit				

³ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr. 004	Projekti: Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor është e ulët kryesisht në Njësitë Administrative pasi edhe numri i fëmijëve të regjistruar është i ulët. Ky fakt mund të vijë si pasojë e infrastrukturës së kopshteve dhe/ose mentalitetit të prindërve mbi arsimin parashkollor si një faktor jo i rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Përgjithësisht, përpara fillimit të vitit shkollor, prindërit dhe komuniteti, njihen me aktivitetet nëpërmjet një plani me aktivitete konkrete. Ata thirren në kopshte duke marrë pjesë në takime të ndryshme në mbështetje të vetë institucionit të kopshtit dhe fëmijëve të tyre. Ajo çka vlen të theksohet, është edhe vazhdimësia e mbajtjes së këtyre aktiviteteve edhe në kopshtet e NJA, pra në të gjitha kopshtet e territorit të Bashkisë Kamëz.		
Përmbledhja e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Mospërfshirja e komunitetit në çështjet e arsimit parashkollor tregon mungesë interesi, që mund të jetë një arsye për numrin e ulët të regjistrimeve në kopshte në Njësitë Administrative. Shkaqet kryesore të këtij problemi mund të lidhen me një mentalitet të theksuar tek prindërit, i cili e konsideron arsimin parashkollor si një faktor jo të rëndësishëm për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve.		
ii Synimi i projektit Një mënyrë për të zgjidhur këtë çështje është përfshirja e komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen përsa i përket arsimit parashkollor. Nëpërmjet aktiviteteve të iniciuara nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit (Sektori i Arsimit Parashkollor) dhe vënia në zbatim nga drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve, synohet: 1. Zhvillimi i fëmijëve. Në këto aktivitete, protagonistët kryesorë do të jenë fëmijët, duke recituar, treguar përralla, kërcyer, etj. Në këtë mënyrë, aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar dhe mësuar gjëra të reja do të rriten; 2. Informimi i komunitetit. Komuniteti do të njihet, nëpërmjet mësueseve, edhe me faktin se sa i rëndësishëm është arsimi dhe nevojën që ekziston që ky komunitet të jetë më aktiv në çështje të arsimit parashkollor. 3. Rritja e regjistrimeve: Aktivitetet do t'u japin prindërve mundësinë të njihen me kopshtet, mësueset dhe përfitimet e arsimit parashkollor, duke rritur kështu normën e regjistrimit. 4. Ulja e grupeve të përziera: Me rritjen e regjistrimeve, do të zvogëlohet numri i fëmijëve në grupet e përziera, duke përmirësuar organizimin e tyre.		
iii Niveli i ndërhyrjes 1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikon aktivitetet. 2. Kalendar i aktiviteteve i dërgohet Drejtorisë së Arsimit dhe Sportit; 3. Organizohen takime me komunitetin për krijimin e Grupit të Vullnetarëve.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Organizimi i aktiviteteve me prindërit dhe komunitetin 2. Takim me Këshillin e Prindërve 3. Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit 4. Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht; 2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht; 3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Kopshtet • Njësitë administrative		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • Komuniteti • OJF

e) Shpenzimet e llogaritura ⁴ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Takim me Këshillin e Prindërve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
4	Organizimi i aktiviteteve	100,000	100,000	100,000	100,000	400,000
	Shuma	100,000	100,000	100,000	100,000	400,000
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

⁴ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit.

Në Bashkinë Kamëz, të gjitha kopshtet i kanë krijuar Këshillin e Prindërve dhe Bordin e Kopshtit. Nga ana tjetër, Komisioni të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit nuk është themeluar në të gjitha kopshtet e Bashkisë Kamëz (20 kopshte). 6 Kopshte, ende nuk kanë mundur të themelojnë këtë Komision

Objektiva specifike:

Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, Fuqizimi i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018 “*Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor*”⁵, dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit
2	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në të gjithë Kopshtet.

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma
005	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
006	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
007	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
008	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.

⁵ Udhëzimi Nr. 25, datë 25.07.2018 “*Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor*».

Klikoni: <https://qbz.gov.al/share/heKG0N0RTu6VE3O1UXEocA>

Lista e Aktiveteve/Projekteve

Nr. 005	Projekti: Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Të gjithë kopshtet e kanë themeluar Këshillin e Prindërve. Nëse do të bënim një analizë të secilit prej 20 kopshteve në total të Bashkisë Kamëz do të arrinim në përfundimin se jo të gjithë e kanë numrin e nevojshëm të anëtarëve në Këshillin e Prindërve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Situata e mungesës së numrit të duhur të anëtarëve apo të mbledhjeve të organizuara në funksion të kopshtit tregon nevojën për ndërhyrje për të forcuar strukturat e Këshillit të Prindërve dhe për të garantuar një përfaqësim të duhur në kopshte. Fuqizimi i kësaj strukture, vjen edhe nga rritja e rolit monitorues nga ana e Bashkisë për funksionimin dhe organizimin e tij.		
ii Synimi i projektit Nëpërmjet këtij projekti synohet: 1. Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve. Në organizimin e aktiviteteve do të kërkohet përfshirja e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe në këtë mënyrë do të rritet angazhimi i tyre në kopsht.		
iii Niveli i ndërhyrjes 1. Hartimi i një protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të këshillit dhe rrugës që këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje. Detajimi nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm siç është Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018 <i>"Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor"</i> ⁶ , që edhe këshilli për çështje të cilat kanë nevojë për zgjidhje nga bashkia, të raportojë pranë bashkisë. 2. Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Prindërve. Ky trajnim do të organizohet së bashku me trajnimin për Bordin e Kopshtit kështu që nuk do të ketë kosto shtesë; 3. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Këshillit të Prindërve për t'i trainuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre; 4. Njësia përgjegjëse për Arsimi Parashkollor ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Këshillin e Prindërve.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të këshillit dhe rrugës që këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje; 2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. 3. Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve nga drejtuesit e kopshteve. 4. Të ftohen të gjithë prindërit, gjatë periudhës që zhvillohen degjesat e buxhetit, në këtë mënyrë prindërit aktivizohen dhe bëhen pjesë e vendimmarrjes. 5. Inkurajimi i prindërve të angazhohen në aktivitetet e kopshteve për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndihmuar në rekrutimin e anëtarëve të rinj.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe drejtuesve. 2. Protokoll i unifikuar mbi mënyrën se si themelohet Këshilli i Prindërve, si raportohen çështjet që diskutohen gjatë mbledhjeve dhe si marrin zgjidhje. 3. Mbajtja e takimeve dhe mbledhjeve të rregullta do të forcojë bashkëpunimin dhe rris efektivitetin në Këshillin e Prindërve. Mbledhjet e rregullta gjithashtu, ndihmojnë në koordinimin e përpjekjeve për përmirësimin e kushteve të kopshteve dhe organizimin e aktiviteteve për fëmijët. 4. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Këshillit dhe prindërve do të rrisë angazhimin e prindërve në procesin arsimor dhe do të përmirësojë dialogun ndërmjet institucioneve arsimore dhe familjeve.		

⁶ Udhëzimi Nr. 25, datë 25.07.2018 *"Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor"*.

Klikoni: <https://qbz.gov.al/share/heKGONORTu6VE3O1UXEocA>

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) - Njësitë Administrative - Drejtuesit e Kopshteve		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) OJF				
e) Shpenzimet e llogaritura⁷ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
4	Ndërgjegjësimi dhe inkurajimi i prindërve për tu bashkuar në aktivitetet e kopshtit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027		g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit				

⁷ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr. 006	Projekti: Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09				
a)Përshkrim i shkurtër i projektit						
i Situata						
Të gjithë kopshtet në bashkinë Kamëz, e kanë themeluar Bordin e Prindërve. Nga 20 kopshte që ka bashkia Kamëz, 16 prej tyre nuk e kanë numrin e parashikuar të anëtarëve në borde, ndërsa 4 kopshte e plotësojnë kriterin. E njëjta situatë paraqitet edhe me numrin e mbledhjeve të cilat nuk mbahen rregullisht.						
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje						
Situata e mungesës së numrit të duhur të anëtarëve apo të mbledhjeve të organizuara në funksion të kopshtit tregon nevojën për ndërhyrje për të forcuar strukturat e Bordit të Kopshtit dhe për të garantuar një përfaqësim të duhur në kopshte. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit, do të sigurojë një menaxhim më të mirë dhe përfaqësim të prindërve, duke ndihmuar në vendimmarrje dhe organizimin e aktiviteteve.						
ii Synimi i projektit						
Nëpërmjet këtij projekti synohet:						
1. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre duke mbajtur mbledhjet e nevojshme për nevojat e kopshtit.						
iii Niveli i ndërhyrjes						
1. Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrat e Bordit të Kopshtit;						
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Bordit për t'i trainuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;						
3. Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Bordin e Kopshtit.						
iv Aktivitetet kryesore të projektit						
1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/kryemësuesve nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Kostot për një person janë 1.5 mijë lekë.						
2. Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit nga drejtuesit e kopshteve.						
3. Monitorim i funksionimit të bordeve nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit (Sektori I Arsimit Parashkollor.						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)						
1. Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit të Kopshteve dhe drejtuesve;						
2. Rritja e ndikimit të Bordit të Kopshtit në menaxhimin e kopshteve.						
3. Mbajtja e takimeve dhe mbledhjeve do të ofrojë një mundësi për të diskutuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që mund të lindin në kopshte, duke përfshirë shqetësimet e prindërve dhe nevojat e fëmijëve.						
4. Monitorim nga ana e Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit do të ndikojë në Parashkollor në funksionimin dhe mbarëvajtjen e bordeve						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
• Njësitë Administrative				• OJF		
e) Shpenzimet e llogaritura ⁸ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.

⁸ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

2	Trajnimi i anëtarëve të Bordit të kopshtit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Monitorimi nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, sektori/personat përgjegjës për arsimin parashkollor	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

Nr. 007	Projekti: Themelimi Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në kopshtet ku mungon	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09				
a)Përshkrim i shkurtër i projektit						
i Situata						
Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit nuk është themeluar në të gjitha kopshtet e Bashkisë Kamëz (20 kopshte). 6 Kopshte, ende nuk kanë mundur ta themelojnë këtë Komision.						
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje						
Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31 "Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë") janë:						
a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjes e mjedisve dhe të pajisjeve;						
b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit;						
c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve;						
ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjedisve e pajisjeve të institucionit.						
Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe mungesa e Komisionit ose funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht. Gjithashtu, për kopshtet brenda godinave të shkollave ku Komisioni është i integruar me Komisionin e Shkollës shkakton të njëjtën problematikë.						
ii Synimi i projektit						
1. Ngritja e Komisionit në të gjitha kopshtet publike të Bashkisë ku ende nuk është ngritur						
2. Informimi i bashkisë rreth problemeve dhe tematikave për të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e bashkisë për t'i dhënë zgjidhje.						
iii Nivelit i ndërhyrjes						
• Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ose miratimi i një projekt vendimi nga KB për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit në kopshte.						
• Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Njësia e Arsimit Parashkollor, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/mësuesit përgjegjës për themelimin e Komisionit të Kopshtit brenda një afati 10 ditor.						
• Themelimi i Komisionit të Kopshtit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki.						
• Drejtuesi i kopshtit njofton Njësinë e Arsimit Parashkollor sa herë që Komisioni i Kopshtit mbledhet dhe çështjet që diskuton.						
iv Aktivitetet kryesore të projektit						
1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht.						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)						
1. Krijimi i Komisionit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
• Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit						
e) Shpenzimet e llogaritura ⁹ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht;	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					

⁹ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr. 008	Projekti: Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09				
a)Përshkrim i shkurtër i projektit						
i Situata						
Sipas Urdhrit Nr.31 datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrejë Komisionin e tij. 6 nga kopshtet publike të kësaj bashkie nuk e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit. Kopshtet e kanë lënë në hije këtë strukturë duke mos i dhënë rëndësinë që i takon dhe duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e kopshteve.						
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje						
Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 „Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë“) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.						
ii Synimi i projektit						
Fuqizimi i komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte.						
iii Niveli i ndërhyrjes						
- Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, organizon një trajnim për drejtuesit e kopshtit për të drejtat dhe detyrimet e Komisionit, mënyrën e adresimit të problemeve, etj. - Drejtuesit e Kopshteve organizojnë takime informuese me anëtarët e Komisionit për të drejtat, detyrimet e tyre dhe mënyrën e adresimit të problemeve.						
iv Aktivitetet kryesore të projektit						
- Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; - Trajnimi i anëtarëve të Komisionit nga drejtuesit e kopshteve.						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)						
Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit dhe drejtuesve të kopshteve.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
- Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit - Njësitë administrative (për organizimin dhe mbështetjen e trajnimeve për emergjencat - Shërbimi zjarrëfikës (për organizimin e trajnimeve për Komisionet) - Drejtoria e Shërbimeve Publike - Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile			- OJF - Qendra shëndetësore - Komunitete fetare			
e) Shpenzimet e llogaritura ¹⁰ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Trajnimi i anëtarëve të Komisionit	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025, 2026, 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

¹⁰ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

3.1 Qëllimi i proceseve kryesore

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejtë përmbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Përmirësimi i procesit të menaxhimit dhe identifikimit të rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe në nevojë për përfshirje sociale.
2. Promovimi i rolit të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i tyre me institucionet e kopshtit.

3.3 Përfshirja sociale

3.3.1 Koncepti i përfshirjes sociale

Parimi i gjithpërfshirjes në arsim, nënkupton krijimin e një sistemi arsimor që siguron mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh aftësitë e tyre, nevojat speciale, ose sfidat që mund të kenë. Ky parim thekson se të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në edukimin e zakonshëm dhe të përfitojnë nga mundësitë e njëjta për të mësuar dhe për të zhvilluar aftësi të plota. Parimi i gjithpërfshirjes synon të eliminojë barrierat që mund të pengojnë fëmijët me nevoja speciale nga pjesëmarrja e plotë në aktivitetet shkollore dhe mësimore.

Në “Kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor”, përmendet gjithëpërfshirja si një nga 9 parimet e saj, që orientojnë zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës. Ky parim, midis të tjerave përcakton që: *“Të gjithë fëmijëve u jepet mundësia të zhvillojnë potencialin e tyre, pavarësisht gjinisë, nivelit social-ekonomik, besimit fetar, racës, grupit etnik ose aftësive të tyre fizike dhe mendore. Çdo fëmijë, është individualitet i papërsëritshëm, përcjell sjellje, mendime dhe nevoja unike”*.

3.3.2 Identifikimi i nevojave për përfshirje

Referuar Ligj nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”¹¹, neni 50, çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Në rastet kur njësi administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

¹¹ Ligj nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Referuar Urdhërit nr. 461 dt 27/07/2022 Për një ndryshim në Urdhërin 313 datë 20/10/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimi, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko social”, i ndryshuar Kreu II, pika 4¹², numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në një ShPS, për një ZVAP, përcaktohet nga numri i nxënësve në institucionet arsimore (kopshte, shkolla) në juridiksionin e ZVA-ve: ShPS në kopshtet dhe shkollat e arsimit bazë, ofrohet sipas normës: Një psikolog/ punonjës social për 300-499 nxënës (ose fëmijë).

Referuar të dhënave të mbledhura nga drejtueset e kopshteve publike, në kopshtet e Bashkisë Kamëz rezultojnë fëmijë rom dhe egjiptian të identifikuar si dhe fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike.

Kështu, 12 prej tyre janë fëmijë romë, 34 fëmijë egjiptian, 127 fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike, 16 të tjerë i përkasin një statusi social tjetër dhe 2 fëmijë janë me urdhër mbrojtjeje nga gjykata.

Numrin më të lartë të fëmijëve romë, e hasim në njësinë Bathore, numrin më të lartë të fëmijëve egjiptianë, në Lagjen Nr.1, numrin më të lartë të fëmijëve me ndihmë ekonomike në Bathore dhe numrin më të lartë të fëmijëve me status social tjetër gjithashtu në njësinë Bathore.

Në bashkinë Kamëz, për çdo familje hartohet një plan ndërhyrje specifike për anëtarët me qëllim fuqizimin e familjes. Pranë qendrave komunitare ofrohen shërbime konkrete për përfshirjen e fëmijëve në aktivitete edukuese, këshillime psikologjike, regjistrim dhe ndjekje në kopshte, etj. Ndërsa, skuadrat e terrenit për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge identifikojnë fëmijët në situatë rruge dhe ata që trajtohen me shërbime specifike për fëmijët në situatë rruge pranë qendrës Multifunkionale, qendër e specializuar për të ofruar shërbime të mbrojtjes sociale dhe integruese për këtë grup social në risk të lartë.

Objektiva specifike:

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Përmirësimi i procesit të menaxhimit dhe identifikimit të rasteve të identikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar.
2. Promovim i politikave të mbrojtjes së fëmijëve.

3.4 Mbrojtja e fëmijëve

3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës

Bazuar në të dhënat e deklaruara nga drejtueset e kopshteve, në rubrikën “Staf mbështetës”, për zërin “Psikologe” dhe “Punonjës social”, psikologë dhe punonjës socialë në kopshtet e Bashkisë për çdo Njësi të saj Administrative rezulton se ka.

Kështu, raportohet se janë 14 Psikologë që ofrojnë shërbimin në kopshtet e bashkisë dhe Njësi Administrative.

- 4 Psikologë në Njësinë Administrative Bathore.
- 2 Psikologë në Njësinë Administrative Paskuqan.

¹² Urdhër nr. 461 dt 27/07/2022 “Për një ndryshim në Urdhërin 313 datë 20/10/2020 Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimi, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko social i ndryshuar”.

- 5 Psikologë në Njësine Administrative Lagjja Nr.2.
- 3 Psikologë në Njësine Administrative Lagjja Nr.1.

Janë 5 Punonjës Socialë që ofrojnë shërbimin e tyre në njësitet si vijon:

- 1 Punonjës Socialë në Njësine Administrative Bathore.
- 1 Punonjës Socialë në Njësine Administrative Paskuqan.
- 2 Punonjës Socialë në Njësine Administrative Lagjja Nr.2.
- 1 Punonjës Socialë në Njësine Administrative Lagjja Nr.1.

Bashkia ka raportuar se ka një Njësi për Mbrojtjen e Fëmijës, e organizuar si një njësi speciale brenda strukturës, përgjegjëse për shërbimet sociale që kanë si detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e çështjeve të fëmijëve në rrezik dhe/ ose në nevojë për mbrojtje. Ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP ka bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni për adresimin e çështjeve të abuzimit dhe mbrojtjes së fëmijës.

Bashkia ka në strukturën e saj një Grup Teknik Ndërsektorial për të trajtuar çështjet e përfshirjes sociale, fëmijëve në nevojë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Bashkia është pjesëmarrëse dhe koordinuese e GTN dhe sipas çështjeve/ problematikave ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si SSHS, ZAV, NJVKSH, policia e shtetit dhe të OSHC, etj. Gjatë vitit të kaluar, GTN ka trajtuar disa çështje.

Objektiva specifike:

Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Hartimi i një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët e kopshteve dhe stafeve pedagogjike në kopshte.
2	Fuqizim i rolit të personave të kontaktit në zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion.
3	Vendosja e PMF në kontakt me stafin e kopshteve në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve duke promovuar punën dhe rolin e tyre.

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Viti 2025	Buxhet Viti 2026	Buxhet Viti 2027	Shuma
009	Fuqizimi dhe promovimi i rolit të Drejtorit/Edukatores në çdo kopsht të cilët do të kujdesen për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
010	Krijimi i Materialeve Mbështetëse për Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Postera,	120,000	120,000	120,000	120,000	480,000

Nr.	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Viti 2025	Buxhet Viti 2026	Buxhet Viti 2027	Shuma
	Filma dhe Tekste për Fëmijë, si dhe Manuale për Stafin Pedagogjik në Kopshte					
011	Promovimi i rolit dhe detyrave të PMF	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.

Përshkrim i Aktiviteve/Projekteve

Nr. 009	Projekti: Fuqizimi dhe promovimi i rolit të Drejtorit/Edukatoreve në çdo kopsht të cilët do të kujdesen për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Është me rëndësi që në çdo kopsht një staf edukatorësh apo përgjegjësish të jetë më tepër i vëmendshëm për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të njohë procedurën e identifikimit dhe raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve. Ndërkohë, në kopshtet me drejtor më vete, është shumë e rëndësishme që këta të fundit të kujdesen për identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përfshirje sociale dhe të kujdesen për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet e kopshteve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje Është e nevojshme që stafi i kopshteve të njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mënyrat e identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Gjithashtu, është e rëndësishme që stafi të jetë i njohur me mënyrën e referimit të çdo rasti të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në Bashki.		
ii Synimi i projektit Për të rritur numrin e fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe për të siguruar trajtimin e çështjes së tyre në mënyrë efikase është e rëndësishme që stafi i kopshtit të njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të vendoset një person kontakti në çdo kopsht, ose këtë rol ta mbulojë drejtori i kopshtit në mbështetje edhe të detyrave të tij, që do të jetë përgjegjës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve (për tu njohur me kanalet e raportimit dhe identifikimit dhe përgjegjësitë që ju takon sipas ligjit).		
iii Niveli i ndërhyrjes 1. Çdo kopsht nën administrimin e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale promovon dhe fuqizon rolin e personit të kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve ku këta mund të jenë Drejtuesit e Kopshteve apo edhe vetë mësuesit; 2. Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopsht (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatorët) bëhen pjesë e mekanizmit të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve; 3. Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopsht (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatorët) është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes në lidhje me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve; 4. Bashkia do të vërë në dispozicion informacion të vazhdueshëm dhe profesional për kopshtet dhe çerdhet për mbrojtjen e fëmijëve; 5. Organizimi i trajnimeve të veçanta për Personat e Kontaktit (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatorët) për të rritur kapacitetet e tyre mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve. Trajnimet organizohen nga NJMF.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Fuqizimi i rolit të personit të kontaktit (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatorët); 2. Dërgimi i të dhënave të Personit të Kontaktit (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatorët) në NJMF në Bashki dhe PMF në NJA; 3. Organizimi i trajnimit të Personave të Kontaktit (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatorët) nga NJMF.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Rritja e numrit të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje. 2. Rritje e kapaciteteve të stafit të kopshteve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve. 3. Menaxhimi efikas i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe çështjeve Sociale (NJMF, PMF)		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • OJF
e) Shpenzimet e llogaritura¹³ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)		

¹³ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Fuqizimi i rolit të Personit të Kontaktit (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatores)	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Dërgimi i të dhënave të NJMF	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
3	Trajnimi i (Drejtuesit e Kopshteve/Edukatores) si persona kyç kontakti	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale			

Nr. 010	Projekti: Krijimi i Materialeve Mbështetëse për Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve: Postera, Filma dhe Tekste për Fëmijë, si dhe Manuale për Stafin Pedagogjik në Kopshte	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ¹⁴ , përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Ligji shpreh qartësisht mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha format dhe mënyrat dhe dokumenti i politikave të mbrojtjes së fëmijëve garanton që në të gjitha sistemet dhe atë të sistemit të arsimit parashkollor të jetë i familjarizuar më të gjitha praktikën dhe procedurat për parandalimin e formave të abuzimit, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, raportimin dhe trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
NJMF pranë Drejtorisë së Shërbimit Social dhe PMF duhet të sigurohen që ligji 18/2017 është i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë stafin e kopshteve dhe bashkisë që janë në kontakt me fëmijët. Për këtë arsye, është e nevojshme të hartohet një dokument bazuar në këtë ligj mbi politikën e mbrojtjes së fëmijëve, apo edhe material të tjera mbështetëse, të përshtatur në gjuhë të kuptueshme jo vetëm për stafin e kopshteve, por edhe për vetë fëmijët, prindërit dhe partnerët e tjerë.		
ii Synimi i projektit Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të jetë një dokument udhëheqës për stafet, prindërit, partnerët e vullnetarët në institucionet edukative parashkollore nën administrimin e bashkive në të cilat punohet me / për fëmijë, për të mbrojtur dhe ruajtur mirëqënien e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo abuzimit. Çdo material i hartuar synon të nxisë garantimin e një sjelljeje institucionale, më të përgjegjshme në kopshtet dhe jo vetëm në bashki në funksion të krijimit të ambienteve më të sigurta për të gjithë fëmijët. Çdo dokument apo material i përgatitur duhet të përcaktojë politika për parandalimin e çdo forme dhune ose abuzimi ndaj fëmijëve, duhet të inkurajojë komunikimin e hapur midis stafit, prindërve dhe fëmijëve për çdo shqetësim që mund të lindë dhe duhet të edukojë fëmijët për të drejtat e tyre dhe mënyrën se si mund të mbrohen.		
iii Niveli i ndërhyrjes 1. Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, NJMF dhe PMF dhe në bashkëpunim me ZVAP dhe/ose OJF të profilizuara në fushën e arsimit ngre grupin e punës për përgatitjen e dokumentit/materiaeve, duke u përkujdesur që të përfshijë dhe specifika që lidhen me kulturën dhe kontekstin e secilës zonë. 2. Krijohet një manual i kuptueshëm me hapa konkretë për stafin e kopshteve. 3. Hartohen procedurat për raportimin e shqetësimeve dhe incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve. 4. Informohet stafi i kopshteve dhe fëmijët për kuptueshmërinë e materialeve të hartuara.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e dokumentave apo materialeve dhe krijimeve në gjuhën e kuptueshme për fëmijët; 2. Konsultimi me prindër dhe mësues; 3. Promovimi i materialeve në të gjitha strukturat e nevojshme; 4. Informim i stafit të kopshtit për politikën e mbrojtjes së fëmijëve		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Krijimi i materialeve apo dokumentave mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve; 2. Njohja më e mirë e stafit të kopshteve, prindërve dhe fëmijëve me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve;		

¹⁴ Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Klikoni:https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/11/04_Ligj_18_2017_23.02.2017_Per_te_drejtat_dhe_mbrojtjen_e_femijes.pdf

3. Pajisja e çdo kopshti me një praktikë të miratuar ligjore të përshtatur sipas grupmoshës së fëmijëve në kopsht që siguron mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve. 4. Pajisja e kopshteve me materiale jo letrare të kuptueshme për fëmijët në mënyrë që këta të fundit të kuptojnë se çfarë është e ndaluar dhe çfarë jo, rastet e abuzimit, rastet e reagimit etj.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale (NJMF, PMF)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) OJF			
e) Shpenzimet e llogaritura¹⁵ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Ngritja e Grupit të Punës	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Konsultimi me prindër dhe mësues	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
4	Promovimi i materialeve/krijimeve në të gjitha strukturat e nevojshme	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
5	Informim i stafit të kopshtit për politikën e mbrojtjes së fëmijëve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale			

¹⁵ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr. 011	Projekti: Promovimi i rolit dhe detyrave të PMF	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Në Bashkinë Kamëz, janë 5 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe 14 Psikologë të shpërndarë në katër Njësi Administrative. Njohja e rolit dhe përgjegjësisë së PMF, shërbimet e tyre si dhe në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë në kopsht si pjesë e mekanizmit për mbrojtjen e fëmijëve është prioritarë për të rritur mundësitë e një shërbimi cilësor në kopsht që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo kohë, jo vetëm gjatë raportimit, por përgjatë gjithë kohëqëndrimit në kopsht të fëmijës.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Njohja dhe kuptimi i rolit dhe përgjegjësisë të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe integrimi i shërbimeve të tyre në kopshtet, është thelbësore për të garantuar një mbrojtje efektive të të drejtave të fëmijëve. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një ambienti më të sigurt dhe mbështetës për fëmijët, jo vetëm gjatë periudhave të raportimit të ndonjë problemi, por gjatë gjithë kohës që ata qëndrojnë në kopsht. Prandaj, është e domosdoshme të rritet kapaciteti dhe të forcohet bashkëpunimi midis institucioneve për të siguruar një shërbim cilësor dhe të qëndrueshëm.		
ii Synimi i projektit Stafi i kopshteve duhet të njihet me PMF, të trajnohen mbi mënyrat e identifikimit të rasteve të fëmijëve të dhunuar, të dinë si të referojnë rastin dhe të kuptojnë rolin që ka PMF për mbrojtjen e fëmijëve. Është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi dhe mirëbesimi mes stafit të kopshteve dhe PMF, në mënyrë që identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të jetë sa më efikas.		
iii Niveli i ndërhyrjes PMF si koordinues të grupeve teknike ndërsektoriale nxisin përfaqësimin e kopshteve nga një person kontakti i zgjedhur sipas VKM 149. Lind nevoja e njohjes së bazës ligjore që ngarkon te gjitha institucionet në kontakt me fëmijën të jenë pjesë e GTN. 1. NJMF dhe PMF organizojnë sesione informuese me stafin e Institucioneve arsimore të kopshteve, mbi rolin e tyre dhe mënyrën e adresimit të çështjeve të fëmijëve tek PMF. 2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë sesione informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit. 3. PMF në NJA kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara nga VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, <i>“Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”</i>.¹⁶		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Organizimi i takimeve informuese me stafin e kopshteve nga NJMF dhe PMF, me qëllim: 1. Informimin mbi rolin e PMF, 2. Diskutimin për çështje të mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrën e adresimit të çështjes pranë PMF. 2. Organizimi i takimeve informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit, Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit.		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Çdo institucion arsimor duhet të jetë i njohur me rolin dhe përgjegjësitë e PMF-së; 2. Numri i telefonit të strukturave të Mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë i afishuar në ambientet e kopshteve; 3. Çështje të mbrojtjes së fëmijëve diskutohen në mënyrë të vazhdueshme në bordin drejtues apo në këshillin e prindërve.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • OJF

¹⁶ VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, *“Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”*.

Klikoni: <https://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>

Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale – NJMF dhe PMF në NJA						
e) Shpenzimet e llogaritura ¹⁷ (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Takime informuese me drejtuesit e kopshteve	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
2	Takime informuese me Këshillin, Bordin dhe Komisionin	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.	Kosto Adm.
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit: 2025 2026 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale			

¹⁷ Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

4.1 Qëllimi i proceseve mbështetëse

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë rekrutimi i mësuesve ose stafit mbështetës apo transporti i fëmijëve për në kopsht.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në trajnimin e stafit të kopshteve, përmirësimin e godinave të kopshteve dhe rritjen e aksesueshmërisë dhe arritjes së kopshtit nga të gjithë fëmijët.

4.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve mbështetëse

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike dhe cilësinë e ushqimit.

4.3 Burimet Njerëzore

4.3.1 Trajnimi i stafit

